



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
GMS/EMP

Lënda: Raport i monitorimit mbi performancën e produkteve/shpenzimeve për periudhën Janar - Prill 2022

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit nr.9 datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr.1, datë 10/01/2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Zyra e Komisionerit, me anë të këtij relacioni/raporti saktësojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për periudhën e 4-mujorit të parë të vitit 2022, të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtëj e tutje “Zyra e Komisionerit” ose KDIMDP).

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Vizioni ynë është të promovojmë një shoqëri që mbështetet në institucione transparente dhe në kontrollues publik/privat të përgjegjshëm, si vlera themelore, me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik-social. Ai realizohet vetëm duke zgjeruar bashkëpunimin me këta aktorë që standardet dhe normat rregullatore të kthehen në mundësi për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe jo arsye për t’i kufizuar apo për t’u shmangur prej tyre.

Kjo materializohet nëpërmjet qëllimit të programit i cili është: nxitja e përputhshmërisë së sektorit publik dhe privat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, vendosja e balancës midis dy të drejtave të shtetasve, duke ofruar ekspertizën për ligjbërësit kombëtarë, me qëllim adoptimin e standardeve evropiane në të dyja fushat. Realizimi i mbikëqyrjeve/inspektimeve për zbatimin e detyrimeve ligjore, vendosjen e sanksioneve administrative në rastet flagrante të shkeljes së detyrimeve, shqyrtimin e ankesave në lidhje me të drejtën për akses në informacionin publik apo cënimin e privatësisë, në bazë të të cilave Komisioneri ushtron vendimmarrjen e tij. Menaxhimi me efektivitet dhe korrektësi i fondeve buxhetore të KDIMDP-së.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2022 dhe në vijim objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- Mbështetja dhe monitorimi i autoriteteve publike lidhur me vënien në zbatim të Programit të Transparencës së rishikuar dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve;

- Rritja e ndërgjegjësimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe nëpunësve të administratës shtetërore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve;
- Shtrirja e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve në të gjitha autoritetet publike;
- Ndërmarrja e hapave institucionale dhe ligjorë, me autoritetet përkatëse, në lidhje me adresimin e plotë të kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të ligjit për të drejtën e informimit, (trajtimi i kërkesave dhe ankesave për informacion nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania).
- Vijimi i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat të sektorëve të veçantë me risk të lartë, duke përgatitur rekomandime unifikues për fushat specifike, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, të diktuar veçanërisht nga situata e shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19;
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtari tregtimi të drejtpërdrejtë;
- Bashkërendimin institucional me kontrolluesit publik për të vijuar mbikëqyrjen dhe monitorimin në funksion të rikuperimit të problematikave të konstatuara në raportin e Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat *online*, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe kontrolluesit publik dhe privat të sektorit të kujdesit shëndetësor;
- Vijimin e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 (realizimin me sukses të projektit të binjakëzimit që po asiston Zyrën e Komisionerit në këtë kuadër për vitin 2021) duke zbatuar përtej vitit 2021, detyrimet që rrjedhin nga ndryshimi i legjislacionit në këtë fushë.
- Intensifikimi i dhënies së kontributit dhe angazhimit aktiv në grupet ndërkombëtare të punës, në kuadër të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);
- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse, trajnuese dhe promovuese për fushat e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit me qëllim ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, me fokus nxënësit e arsimit parauniversitar, studentëve, apo përfaqësues të komuniteteve minoritare etnike/kulturore.
- Marrja e masave konkrete në lidhje me thirrjet e pa kërkuara telefonike ose dërgimit të mesazheve me postë elektronike;
- Forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të ligjit me *acquis communautaire*;

Në përdorimin e fondeve buxhetore, Zyra e Komisionerit është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Gjatë këtij raportimi ritheksojmë mungesën e angazhimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për gjetjen e një zgjidhje alternative apo ndërhyrje teknike në sistemin AFMIS, lidhur me mënyrën e aksesimit dhe hyrjes në këtë platform, e cila të jetë në përputhshmëri të plotë me

legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo ka bërë që ende Zyra e Komisionerit të mos jetë e përfshirë në këtë sistem të qëndëruar tashmë, për secilin modul: hedhja e të dhënave për përgatitjen e PBA 2023-2025, ekzekutimin/detajimin/monitorimin e buxhetit. Mospërfshirja e Zyrës së Komisionerit ka sjellë edhe pengesa në ekzekutimin e buxhetit kryesisht në shpenzimet kapitale, pasi fondet për një nga projektet është celur i ngrirë për mungesë aksesimi në AFMIS, problematikë e njohur dhe ende e pazgjidhur nga ana juaj prej vitit 2020.

Produkti i vetëm i Programit 0110, është **Mbikëqyrje/inspektime të kryera & ankesa të trajtuara**, ku parashikimi është nr.1660 veprime, i ndryshuar

E drejta e informimit :

➤ Autoritetet Publike me programe dhe transparencë të plotë

Sigurimi i Transparencës së veprimtarisë së Autoriteteve Publike, nëpërmjet realizimit të proceseve të monitorimit/mbikëqyrjes së elementëve të ndryshëm të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, të autoriteteve publike, të cilat kanë hartuar dhe/ose përditësuar programin e transparencës, forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit, përditësimi në regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, seancave dëgjimore dhe dhënien e rekomandimeve e vendimeve.

➤ Trajtim i ankesave brenda afateve dhe (kthim përgjigje/inspektime/vendime, kryesisht në bazë të ankesave).

Ankesa të trajtuara në kuadër të parashikimeve të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit” si dhe Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, hetime të kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendime të dhëna, duke rritur në këtë mënyrë kontrollin mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesimi në informacion.

Mbrojtja e të dhënave personale

➤ Mbikëqyrje dhe inspektime.

Nëpërmjet procedurave për realizimin e këtij produkti do të bëhet e mundur minimizimi i rrezikut të cënimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale; Ndërgjegjësimi dhe disiplinimi i kontrolluesve; Krijimi i praktikës së mirë për kontrolluesit.

➤ Ankesa të trajtuara

Trajtimi në kohë i ankesave të ardhura nga subjektet e të dhënave personale, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale. Për zgjidhjen dhe trajtimin e ankesave ndiqen hapa procedurale si kontaktimi i vazhdueshëm me subjektin mbi paraqitjen e provave, kërkesë informacioni paraprake nga kontrolluesi, seanca dëgjimore të zhvilluara

deri në zgjidhjen përfundimtare dhe vendimet e dhëna, duke rritur në këtë mënyrë kontrollin mbi veprimtarinë e kontrolluesve publik e privat

Për Zyrën e Komisionerit është miratuar vetëm një program buxhetor, buxheti i së cilës konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të zyrës, në drejtim të monitorimit të ligjeve respektive, për arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Fondet buxhetore të miratuara për vitin 2022 për KDIMDP-në, në vlerën **73.712**(në mijë) lekë, referuar edhe ndryshimeve të Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 , duke përfshirë edhe fondin e veçantë, të cilat paraqiten sipas strukturës së mëposhtme:

| Llog. Ekonomike | Përshkrimi | Plani fillestar i buxhetit viti 2021 (në mijë lekë) I ndryshuar |
|------------------------|---------------------------------------|--|
| 600 | Fond Page | 44.402 |
| 601 | Kontrib. Sig. Shoq& Shënd. | 8.092 |
| 602 | Mallra dhe shërbime të tjera | 14.128 |
| 605 | Transferta korente jashtë vendit | 100 |
| 606 | Transf. për Buxh. Fam. & Individ | 240 |
| 230-231 | Shpenzime kapitale | 6.500 |
| | Paisje zyre, elektronike/kompjuterike | 1.000 |
| | Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve | 5.500 |
| 606 | Fondi i veçantë | 250 |
| | T o t a l i | 73.712 |

Ndërsa vlera e mbartur nga viti 2021, sipas artikujve buxhetore, paraqitet për sa e si më poshtë:

- 1- Shpenzime operative në vlerën 8.156.612 lekë
- 2- Shpenzime kapitale në vlerën 24.422.871 lekë

Nga përdorimi i fondeve të krijuara me kontributin e donatorëve (2019-2021), Zyra e Komisionerit arriti të mbulojë financimin e disa aktiviteteve si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së institucionit, duke realizuar në këtë mënyrë performancë në rritje të treguesve dhe indikatorëve të parashikuar edhe në strategji të veçanta ndërinstitucionale në të cilat Zyra e Komisionerit është pjesë.

1. Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare

Zyra e Komisionerit ka ngritur sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në Ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar si dhe në parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitetet, transparencë, ekonomi dhe efijensë.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor me ndryshimet gjatë vitit, janë shpenzuar 20.705 (në mijë lekë), përfshirë edhe përdorimin e fondit të veçantë.

Tabela e mëposhtme pasqyron në %, çdo kategori shpenzimesh, përkundrejt totalit të buxhetit, si dhe realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT (i ndryshuar)

Janar – Prill 2022

000 / lekë

| Nr. | EMËRTIMI | PLAN VJETOR 2022 (i ndryshuar) | PËRQINDJE KUNDREJT TOTALIT | FAKT 4- MUJOR | PËRQINDJE REALIZIMI KUNDREJT PLANIT VJETOR |
|-----|--|------------------------------------|----------------------------------|------------------|---|
| 1 | Paga | 44.402 | 60 % | 14.988 | 34 % |
| 2 | Sigurime shoqërore | 8.092 | 11% | 2.486 | 31 % |
| 3 | Mallra e shërbime të tjera | 14.128 | 19 % | 3.090 | 22 % |
| 4 | Investime | 6.500 | 8.8 % | 0 | 0 |
| 5 | Transferta te buxhetet familjare | 240 | 0.3% | 80 | 23.5 % |
| 6 | Kuotizacion | 100 | 0.01 % | 0 | 0 |
| | | 73.462 | | 20.644 | 28 % |
| 7 | Fondi i vecantë | 250 | 0.3 % | 60 | 24 % |
| | Totali | 73.712 | 100 | 20.704 | 28 % |

o **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore.**

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2022, për periudhën e raportuar Zyra e Komisionerit ka shpenzuar **vlerën buxhetore 20.644 (në mijë lekë)**. Është realizuar buxheti në tërësi në masën 28%, kundrejt planit vjetor ose 80% kundrejt planit të 4-mujorit të parë të vitit 2022.

- o **Fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqërore**, është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **14.988 (në mijë) lekë** për paga si dhe **2.486 (në mijë) lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, e rreth 92 % e fondit të planifikuar për 4-mujorin e parë ose rreth 33% të planit vjetor të këtij shpenzimi (600-601)

Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e rezultateve të rekrutimit, për çdo shpallje të publikuar. Për vitin 2022 janë ndjekur 8 procedura, ndërkohë janë emëruar 4 punonjës. Janë kryer procedurat e emërimeve të përkohshme, për pozicionet e deklaruar përkohësisht vakante, për shkak të largimeve në detyra të tjera jashtë institucionit apo atyre me raport paaftësie (leje lindje) si dhe të tjera emërime me kontrata me afat të caktuar (punë me kohë të reduktuar 6 orë). Referuar planit vjetor të rekrutimeve, deri me 30 Prill janë krijuar apo mbetur 5 vende vakante, nga të cilat 2 pozicione të nivelit të mesëm drejtues, 2 inspektor dhe 1 shef sektori, të nivelit të ulët drejtues, ku një pjesë e tyre janë në proces.

Është punuar për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit (për periudhën Janar-Prill), nëpërmjet trajnimeve të ASPA.

- **Fondi për Shpenzime Korente të tjera (602-606)**, për periudhën Janar-Prill 2022, është realizuar në vlerën **3170 (në mijë) lekë**, ose rreth 46% e fondit të planifikuar për 4-mujorin e parë ose rreth **22 %** të planit vjetor të këtij shpenzimi (602-606) Ky fond është realizuar për:
 - Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si detyrime energji elektrike, ujë, shërbime bankare, postare e telefonike.
 - Shpenzime në funksion të realizimit të qëllimit të Komisionerit, ku për platformat e instaluara janë ndërmarrë procedurat e mirëmbajtjes vjetore të tyre
 - Shpenzime për sigurimin e godinave e të mjeteve të transportit si dhe shërbime të dezinfektimit në situatën covid-19
 - Shpenzime të tjera mirëmbajtje/furnizime, e të tjera shërbime bazë

Mosrealizimet në këtë zë kanë ardhur si pasojë e vijimit të pezullimit të aktivitetit nga situata e virusit covid-19, në fillim viti, për shkak të së cilës janë pezulluar pjesëmarrja gjithë aktivitetet brenda e jashtë vendit (të planifikuara). Një pjesë e fondeve të shpenzimeve operative, janë reduktuar në masën 3.532 (në mijë) lekë, referuar Aktit Normativ për rishikimin e buxhetit të vitit 2022, e cila pakësoi një pjesë të shpenzimeve të parashikuara për mbulimin e aktiviteteve jashtë apo brenda vendit, të cilat kanë dhe mund të ndikojnë në realizimin e treguesve sasiorë.

- **Fondi për shpenzime investime (zëri 231)**, ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve është 6.500 (në mijë) lekë, i ndarë në dy projekte
 - Blerje Pajisje zyre 1.000 (në mijë) lekë
 - Platformë Regjistri i thirrjeve të padëshiruara 5.500 (në mijë) lekë

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investime, Zyra e Komisionerit ende nuk ka hartuar planin e prokurimeve, pasi detajimi është bërë me vonesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku fondi për Regjistrin elektronik të thirrjeve të padëshiruara është çelur i ngrirë, me arsyetimin e mospërfshirjes dhe hedhjes së të dhënave në AFMIS, proces i cili nuk ka nisur dhe do të vijojë të jetë në këtë status deri sa Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat për zgjidhjen teknike, në respektim dhe përputhshmëri me legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit ka evidentuar disa

çështje sigurie të cilat kanë nevojë për ndërhyrje urgjente në aspektin e licensimeve dhe pajisjeve hardware dhe software apo dhe një plan dixhitalizimi të disa proceseve të punës. Mbetet në prioritet që brenda 6-mujorit të parë të miratohet plani i zbatimit për dixhitalizimin dhe sigurinë për nisjen më pas të procedurave prokuruese.

Në Aneksin nr. 3 është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për periudhën e 4-mujorit të parë të vitit 2022 Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është kryer nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna. Produktet kryesore janë:

Nënprodukti A: Trajtim i ankesave brenda afateve (kthim përgjigje/inspektime/vendime, kryesisht në bazë të ankesave (i ndryshuar), rreth 1000+-)

Zyra e Komisionerit ka realizuar monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit, duke shqyrtuar jo vetëm ankesat e depozituara, por duke kryer gjithashtu inspektime, seanca dëgjimore si dhe duke marrë vendime urdhërimi apo sanksionimi sipas ligjit për rastet kur është konstatuar refuzim i padrejtë i vënies në dispozicion të informacionit.

Për periudhën e raportimit (4-mujorit të parë të vitit 2022), Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit ka administruar **414 ankesa** nga qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gazetarë investigativë, si dhe ka vijuar shqyrtimi i **49 ankesave** të mbartura nga viti 2021. Nga ankesat e paraqitura, për 263 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar është vënë në dispozicion të ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Ndërkaq, 64 ankesa janë në proces shqyrtimi, 5 ankesa janë konsideruar të paplota, 33 ankesa janë jashtë afatit, 80 ankesa janë konsideruar jashtë objektit dhe 6 prej tyre janë refuzuar bazuar në kufizimet e nenit 17, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 12 seanca dëgjimore, **9 inspektime**, janë dhënë 10 vendime nga të cilat 8 vendime urdhërimi, 2 vendime mospranimi.

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit. Ky është një tregues cilësor i veprimitarisë së Zyrës së Komisionerit, ku qytetari merr atë çfarë kërkon dhe i nevojitet.

Në tërësi Nënprodukti A:463+ 9 (ankesa+inspektime) realizuar mbi 47% të pritshmërisë.

Nënprodukti B- Monitorim i Autoriteteve Publike me programe transparencë (380+-monitorime) .

Zyra e Komisionerit e ka të përditësuar listën e autoriteteve publike, e cila pas ndryshimeve, për shkak të reformës së riorganizimit strukturor të organeve dhe institucioneve të administratës shtetërore, ku rezultojnë **374 autoritete publike**.

Ligji për të drejtën e informimit garanton transparencën proaktive dhe nxit integritetin, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike. Një prej instrumenteve kryesorë që kontribuon në këtë drejtim, është programi i transparencës.

Si rezultat i monitorimeve të vazhdueshme, dhe aktiviteteve të tjera trajnuese/inspektuese nga Zyra e Komisionerit, gjatë këtij viti, vërehet një përmirësim, si në shtimin e numrit të autoriteteve të cilat kanë publikuar programin e transparencës, ashtu edhe në informacionin e publikuar në rubrikat e përfshira në këtë program.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka miratuar modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, Zyra e Komisionerit ka vijuar periodikisht me monitorimin e 100 Autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë në lidhje me publikimin e “Programit të Transparencës të Rishikuar” si dhe 16 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore në lidhje me publikimin e “*Programit Model të Transparencës për NJVV*”.

Zyra e Komisionerit gjatë periudhës së raportimit (Janar-Prill) ka dhënë 28 Rekomandime për zbatimin e Programit të Transparencës ndaj Prokurorive. Ndërkohë gjatë këtij 4 mujori është ushtruar verifikimi i Rekomandimeve për zbatimin e programeve të transparencës së prokurorive.

Nënprodukti B: Nga 116 monitorime të AP, nga 374 AP. Është një tregues, relativisht pozitiv krahasuar me pritshmëritë (monitorim për të gjithë AP), duke mos përfshirë numrin e rekomandimeve apo inspektimeve.

➤ **Të tjera aktivitete në funksion të rritjes së transparencës**

❖ **Kërkesa nëpërmjet regjistrin**

-Me qëllim zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe duke synuar bërjen sa më efektive të së drejtës për informim si një e drejtë kushtetuese dhe një mjet për garantimin e llogaridhënies së autoriteteve publike, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka ngritur “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPDI), miratuar me VKM nr. 145/2018. Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për 4-mujorin e parë të vitit 2022 është instaluar në 50 autoritetet publike, duke e çuar në 145 numrin total të autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik. Zyra e Komisionerit me qëllim përmbushjen e rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit, si dhe detyrimit ligjor parashikuar nga neni 14, i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, ka bashkëpunuar me AKSHI-n për instalimin e sistemit AMS, për ofrimin e shërbimeve të “kërkesës për informacion publik” dhe “ankesës për mos dhënie informacioni”, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania. Ky shërbim në 4-mujorin e

parë të vitit 2022 ofrohet për qytetarët në 75 Autoritete Publike, duke e çuar numrin në **136 autoritete publike në total.**

Nga ana e Drejtorisë së Monitorimit të Programeve të Transparencës është përditësuar lista dhe emërtimet e autoriteteve publike, të dhënat e kontakteve të koordinatorëve për të drejtën e informimit në autoritetet publike, duke bërë të mundur lidhjen e linkut të programit të transparencës së Autoritetit Publik në portalin Pyetshtetin.

Aktivitete të tjera mbështetëse.

Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus nxitjen e transparencës dhe llogaridhënien e autoriteteve publike është pjesë e :

- ✓ Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 dhe Plani i ri i aktiviteteve 2018-2022;
- ✓ Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2020-2023;
- ✓ Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019-2023;
- ✓ Strategjisë për “Mirëqeverisjen”;
- ✓ Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021.

Zyra e Komisionerit ka nisur në bashkëpunim me Ambasadën Britanike për projektin "*Improving the openness and accountability of the governments of the Western Balkans through the development of effective strategic communications*". Ky është një projekt trevjeçar i implementuar nga *Government Communications Service International* i zyrës së kabinetit të Mbretërisë së Bashkuar. Në këtë kuadër janë zhvilluar disa takime me përfaqësues të autoriteteve publike, Zyrës së Komisionerit dhe ekspertëve britanikë. Në përfundim të tyre janë realizuar produkte konkrete (manual, materiale sqaruese dhe promocionale).

-Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka iniciuar një tur në të 12 qarqet e vendit, brenda vitit 2022, në kuadër të projektit “Ditët e Transparencës”, me pjesëmarrje të të gjithë autoriteteve publike që ushtrojnë veprimtarinë në Qarkun e tyre.

-Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë në mjaft takime/tryeza konsultuese trajnuese me pjesëmarrjen e partnerëve ndërkombëtarë, ekspertëve të fushës, shoqërisë civile. Në fokus të tyre ka qenë vlerësimi i ecurisë së zbatimit të legjislacionit të të drejtës për informim dhe bashkëpunimi në kuadër të projekteve që forcojnë dhe nxisin transparencën dhe llogaridhënien e Autoriteteve Publike.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

➤ Nënprodukti C: Mbikëqyrje dhe inspektime, i ndryshuar, (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +-30), i ndryshuar

Për këtë periudhë janë realizuar **7 hetime administrative** në terren në kontrollues publik dhe privat. Inspektimet janë iniciuar si në bazë të ankesave (1), por dhe edhe nga vetë Zyra e Komisionerit (6) në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

➤ Rekomandime/Vendime gjobe

Komisioneri në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, është shprehur me:

- **1 vendim** gjobe që korrespondon me **3 sanksione** administrative dhënë në sektorin privat.
- Janë zhvilluar **2 seanca dëgjimore**, pas përfundimit të hetimeve administrative.

Hetimet e tjera janë ende në proces.

- Janë trajtuar **2 praktika** për autorizimin e transferimit në disa shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në përmbushje të detyrimit ligjor për të njoftuar, kanë njoftuar rreth **20** subjekte kontrolluese. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri tani ka arritur në **5836**.

Nënprodukti C: (Inspektime mbi bazë ankese dhe kryesisht +- 30), i ndryshuar, pa përfshirë veprime të tjera vendime, rekomandime, sanksione, urdhërime është realizuar nga ana sasiore **7 mbikqyrje**

-Nënprodukti D. Ankesa të trajtuara (nr.rreth +- 250), i ndryshuar

Trajtimin me efikasitet në një kohë sa më të shkurtër dhe transparent të ankesave të shtetasve dhe subjekteve të ndryshme. Janë trajtuar **134 ankesa** nga subjektet e të dhënave personale në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale.

Gjatë periudhës së raportimit (4 - mujori i parë 2022), janë trajtuar **134 ankesa** nga subjektet e të dhënave personale në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, e cila tregon një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarëve në cilësinë e subjektit të të dhënave në lidhje me ushtrimin e të drejtave që garanton ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera, të drejtës për t’u ankuar.

Nënprodukti D: Ankesa të trajtuara, pa përfshirë vendime, rekomandime është realizuar nga ana sasiore 134 ankesa, ku pritshmeritë janë në trendin rritës.

❖ **Aktivitetet të tjera mbështetëse.**

Si pjesë e iniciativave të Zyrës së Komisionerit, në kuadër të 28 Janarit, Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, është organizuar një takim me mbi 100 përfaqësues dhe nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale nga institucione qendrore, të pavarura dhe të vetëqeverisjes vendore, me temë “**Prezantimin e rezultateve të Pyetësorit për vlerësimin e njohurive të autoriteteve publike në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale**”.

Nëpërmjet rezultateve të tij, institucionit i është mundur një panoramë e gjerë për nivelin e njohurive të administratës në lidhje me garantimin e të drejtës kushtetuese për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publik. Gjithashtu, Pyetëtori synoi vlerësimin dhe zbatimin e detyrimeve të kuadrit ligjor në fuqi, i cili rregullon procesin e përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve.

Një tjetër aktivitet që mbështet të dy shtyllat për garantimin e dy të drejtave **është Shërbimi ligjor**, edhe pse në vitet e kaluara janë trajtuar si produkt më vete.

❖ **Hartimin e projekt akteve**

- Është hartuar Raporti Vjetor 2021 mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale drejtuar Kuvendit.
- Është hartuar programi i punës për vitin 2022, për veprimtarinë e punës së Zyrës së Komisionerit.
- Është hartuar draft/ Strategjia Institucionale e Zyrës së Komisionerit për periudhën 2022–2024.

❖ **Dhënie mendimi/opinione ligjore**

Zyra e Komisionerit ka dhënë **20** mendime ligjore për;

- **4** projektvendime;
- **5** projekt/ligje;
- **3** dhenie mendimi për marrëveshje si dhe
- **10** opinione ligjore të paraqitura nga kontrollues publik e privat.

Është hartuar Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) të Republikës së Kosovës, nënshkruar në datë 21.04.2022.

Raportime

Është raportuar në mënyrë periodike në kuadër të rekomandimeve të lëna nga Raporti i Shtetit i BE-së për Shqipërinë, për vitin 2022, për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, “Kriteri Politik” dhe Kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”. Në këtë kuadër është:

- raportuar mbi Planin e Masave për zbatimin e rekomandimeve të KE për Zyrën e Komisionerit dërguar nga Ministri i Drejtësisë; Është raportuar për nënkomitetin e 13-të në drejtësi, liri dhe siguri;
- është dhënë kontribut mbi ToC për përafrimin e kodit të ri penal me direktivën e BE-së 2018/849 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 20 majit 2015 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit”;
- janë përgatitur dokumentat e analizës së mangësive ligjore dhe analizës së mangësive institucionale dhe administrative (LGA dhe IAGA), si dhe prezantimet Power Point për Mock Bilateral screening;

Është raportuar në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr.134/2018 “Për miratimin e Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik”, mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Zyra e Komisionerit, për autoritet publike si dhe statusin e zbatueshmërisë së tyre për periudhën janar - prill 2022.

Është raportuar në kuadër të zbatimit të “Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të saj të Veprimit 2018-2021”.

Është raportuar në kuadër të zbatimit të “Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019–2023”.

❖ *Procese gjyqësore*

Për periudhën raportuese, për Zyrën e Komisionerit, janë ekzekutuar **5** vendime gjobe për vendime të dhëna në vitin 2021, **3** prej tyre në zbatim të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe me **2** vendime gjobe në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimi .

-Të ardhurat nga sanksionet/gjoba

Të ardhurat nga veprimtaria kryesore (sanksionet administrative), për periudhën Janar–Prill, konfirmohet nga Dega e Thesarit, Tiranë, se arketimet janë në masën 380.000 (në mijë lekë), sanksione të cilat derdhen në masën 100% në buxhetin e shtetit.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi